

Informacion për aktivitetet e zhvilluar në kuadër të “Muajit të hapur në KLSH” për Periudhën 26 nëntor-7 dhjetor 2018

Në datën 26 nëntor në ambientet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, në sallën “Lech Kaczynski”, u zhvillua një takim me studiuesin Uran Butka dhe shkrimtarin e studiuesin Agron Tufa për veprën e Mid'hat Frashërit. Ky takim u zhvillua në kuadër të aktiviteteve të muajit të hapur.

Në këtë aktivitet morën pjesë Kryetari i KLSH dhe auditues të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe gazetarë nga fusha e kulturës.



Aktivitetin e hapi Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj, i cili nënvizoi faktin që ishte një nder i veçantë për institucionin organizimi i këtij aktiviteti që i kushtohet veprës së Mid'had Frashërit. Z.Leskaj përmendi se vepra e zgjedhur e Mid'hat Frashërit është një kulturë e jashtëzakonshme, që i kthehet kombit shqiptar, dhe bashkë me të edhe vetë Mid'hat Frashëri.

Në fjalën e tij Historiani Uran Butka, tregoi para auditorit se kjo vepër kryesisht kulturore, ka tre volume. Në vëllimin e parë përfshihet publicistika e tij, në të dytin studimet historike, kulturore, politike sociale etj., në vëllimin e tretë janë krijimtaria dhe kujtimet e tij, që janë një pasuri shumë e madhe për historinë e kombit, veçanërisht letërkëmbimi që është ndër më të jashtëzakonshmit në historinë e literaturës shqipe, përshkrimet e udhëtimeve në të gjithë botën, ditarët, etj.”

Shkrimtari Agron Tufa mori fjalën dhe e cilësoi trashëgiminë memuaristike të Mid'hat Frashërit si një vepër që na njeh me disa segmente të rëndësishme të ngjarjeve historike e politike të Shqipërisë në agun e saj shtetformues, sikundërse na sjell nga afër portrete personalitetesh politike e kulturore të çerek shekullit të parë të shekullit XX.

(Materialin e plotë për këtë aktivitet e gjeni në linkun http://www.klsh.org.al/ëeb/13_aktiviteti_per_mid_27hat_frasherin_4488.pdf)

Departamenti i Auditimit të Performancës zhvilloi aktivitetin “Performanca junior”. Audituesit e rinj ndajnë eksperiencën dhe vizionin e tyre për të ardhmen departamentale

Në datën 27 nëntor 2018, Drejtori i Departamentit të performancës , z.Rinald Muça sëbashku me audituesit e rinj të rekrutuar gjatë vitit 2018, mbajtën leksionin me temë “Performanca junior”. Ky takim, i cili u realizua në kuadër të Muajit të hapur mbledhi auditues nga Departamenti i performancës dhe departamente të tjera auditimi të KLSH-së.



Në fjalën e tij, z.Muça prezantoi audituesit e rinj të rekrutuar në departamentin e performancës dhe theksoi rëndësinë e auditimit të performancës në raport me auditimet e tjera (financiarë dhe përputhshmërie). Gjithashtu z.Muça i cilësoi auditimet e performancës si krijuese dhe sfiduese sidomos kur në këto auditime audituesit e performancës janë të rinj dhe vijnë me background-e të ndryshme arsimore dhe profesionale.

Audituesit e rinj prezantuan eksperiencën e tyre në departamentin e auditimit të performancës. Në të gjitha prezantimet, të cilat u referuan nga audituesit, rëndësi u vu në ndihmesën që kanë sjellë manualët e auditimit të performancës. Të gjithë audituesit theksuan se dy botimet e manualeve të performancës i kishin ndihmuar në konceptet e auditimit të performancës, por edhe i ndihmonin të realizonin auditime sa më performante. Ata gjithashtu falënderuan kolegët me përvojë për mbështetjen gjatë procesit të auditimit dhe përgatitjes së materialeve përfundimtare.



Aktiviteti u realizua në mënyrë interaktive dhe pati bashkëbisedime dhe komente nga ana e pjesëmarrësve dhe drejtorit të departamentit të auditimit të performancës.

10 Risitë e KLSH-së në vitet 2012-2018 që kanë ndikuar në modernizimin e institucionit

Në datën 6 dhjetor në sallën “Lech Kaczynski”, u zhvillua një takim me auditues të Departamenteve të Auditimit dhe të strukturave mbështetëse. Në këtë takim, zj.Irena Islami, Drejtor i Drejtorisë së Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë evidentoi 10 Risitë e KLSH-së në vitet 2012-2018 që kanë ndikuar në modernizimin e institucionit.

Duke vlerësuar misionin e tij si agjent i publikut dhe i Kuvendit, për përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të burimeve dhe fondeve publike, KLSH në shtatë vitet e fundit, ka synuar forcimin e besimit të qytetarit dhe publikut në tërësi, nëpërmjet njohjes më nga afër të veprimtarisë së tij, auditimeve dhe rezultateve të tyre, si dhe partneritetet që ka krijuar brenda dhe jashtë vendit për të përmirësuar qeverisjen publike, duke u përpjekur të luftojë në thellësi korrupsionin.

Mbështetur në moton e Kongresit të IX-të të EUROSAT-t, zhvilluar në Holandë, *“Kur është hera e fundit që ke bërë diçka për herë të parë?”*, dëshiroj të ndaj me publikun 10 risitë e KLSH-së në vitet 2012-2018, të cilat më parë as nuk ravijëzoheshin, ndërsa tani janë bërë të prekshme për të gjithë.

1. Ligji i Ri i KLSH-së

Miratimi i ligjit të ri nga Parlamenti, nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së", në nëntor 2014, konsiderohet si reforma më e rëndësishme në historinë e KLSH-së që nga viti 1992. Ligji është plotësisht në përputhje me standardet e INTOSAI-t dhe ka qenë një rekomandim i kahershëm i BE, i përfshirë në Raportet e Progresit të KE për Shqipërinë. Parlamenti shqiptar, me votën e tij më 27 nëntor 2014, sanksionoi saktësisht një ligj të tillë për KLSH-në, duke shënuar një hap shumë të rëndësishëm në integrimin evropian të vendit.

2. Auditimet e Performancës

Për herë të parë në KLSH, në tetor të vitit 2012 është krijuar Departamenti i Auditimit të Performancës. Ligji i Ri specifikoi dhe mundësoi realizimin e këtij lloji auditimi nga KLSH. Auditimet e performancës gjatë 2012-2018 theksuan shumëllojshmërinë dhe ndjeshmërinë e çështjeve që mbuluan reformat ekonomike, sociale dhe kulturore, çështjet energjetike dhe mjedisore, aspektet makro dhe mikro të realitetit shqiptar, etj.

Auditimi i Performancës në strategjinë e KLSH-së është një nga shtyllat moderne të zhvillimit të KLSH-së, në përputhje me përvojën globale. Auditimi i Performancës pati një rritje të konsiderueshme në këto vite, duke filluar me katër auditime në vitin 2012 dhe duke realizuar 15 në vitin 2017.

3. Auditimet IT

KLSH ka bërë hapa të konsiderueshëm në zhvillimin e auditimeve të Teknologjisë së informacionit dhe për herë të parë në KLSH kemi një Departament të Auditimit IT. Në Strategjinë e Zhvillimit të KLSH-së, për vitet 2018-2022, i është dhënë një rëndësi e veçantë auditimit të IT dhe është punuar në drejtim të rritjes së kapaciteteve, zbatimin e standardeve profesionale dhe shkëmbimin e eksperiencave. Gjatë vitit 2018 do të realizohen gjashtë auditime të tilla, kundrejt dy auditimeve që janë realizuar në vitin 2015.

4. Kallëzimet penale

KLSH ka luftuar pa kompromis kundër abuzimeve financiare dhe mashtrimit me pronën publike, duke synuar përmirësimin e qeverisjes publike, duke thelluar luftën pa kompromis ndaj zyrtarëve të korrumpuar, kryesisht me adresim e kallëzimeve penale, me akuzat “Shpërdorim detyre”, “Shkelje e barazisë në tendera”, etj. Në vitet 2012-2018, KLSH ka përcjellë 300 kallëzime penale për 945 persona, ose thënë ndryshe ka adresuar çdo javë një kallëzim penal për zyrtarë të nivelit të lartë dhe të mesëm, konstatuar me shkelje të rënda nga auditimet e KLSH-së.

5. Botimet e KLSH-së

Institucioni i KLSH-së ka zgjeruar ndjeshëm kanalet e komunikimit me median e shkruar të vendit, gazetatat dhe revistat, gjatë periudhës 2012-2018 dhe qasja e re e KLSH-së është në përputhje të plotë dhe bazohet në standardet profesionale të auditimit publik suprem ISSAI-t.

Këtij qëllimi i ka shërbyer edhe kolona e botimeve të KLSH, e cila ka aktualisht 95 botime, ndërsa gjatë 20 viteve (1991-2011), KLSH ka pasur vetëm 12 botime, që janë më së shumti broshura modeste. Botimet e KLSH-së, krahas informimit të opinionit të gjerë publik, i ndihmojnë audituesit publikë për formimin e kapaciteteve të tyre, zbatimin rigoroz të standardeve të INTOSAI-t dhe shkëmbimin e eksperiencave të mira të punës, në bazë të motos së INTOSAI-t “Nga eksperiencia e përbashkët përfitojnë të gjithë”.

6. Revista Kërkimore-Shkencore “Auditimi Publik”

Duke filluar nga viti 2012, KLSH publikoi për herë të parë një revistë kërkimore-shkencore, “Auditimi Publik”. Revista ka një bord shkencor me akademikë dhe profesorë të shquar, shqiptarë dhe të huaj, në fushën e ekonomisë, ligjit, inxhinierisë, etj.

Revista Shkencore “Auditimi Publik”, ka arritur në numrin 20 të saj dhe vijon “të qëndrojë me dinjitet”, megjithëse shumë nga ne paragjykonin që KLSH do të mund të nxirrte tre Revista të tilla me karakter të theksuar studimor çdo vit.

Në këtë Revistë kanë kontribuar me shkrimet e tyre personalitete të fushës së Ekonomisë nga vendi si dhe personalitete të njohura dhe me eksperiencë nga SAI-t nga vende të rajonit e më gjerë, duke i dhënë “Auditimit Publik” një vlerë të shtuar dhe një përmasë rajonale, duke kontribuar në mbledhjen e mendimit të përparuar të profesionistëve të fushës së auditimit.

7. Muaji i Hapur

Transparenca e aktivitetit të KLSH-së është një nga treguesit kryesorë të modernizmit të tij si institucion dhe komunikimit shumëdimensional. KLSH-ja ka pasur një komunikim të pandërprerë me qytetarët gjatë këtyre shtatë viteve, kryesisht përmes bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe mediat, si dhe përmes përgjigjeve ndaj letrave të qytetarëve.

Bazuar në sa më sipër dhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, KLSH ka organizuar Javën dhe Muajin e Hapur për Qytetarët gjatë viteve të fundit.

Gjatë këtij muaji qytetarët kanë pasur mundësinë të vizitojnë ambientet e KLSH-së dhe të marrin informacion mbi historinë e institucionit, arrijtjet në 93 vitet e ekzistencës së tij, përmes mini-muzeut në sallën kryesore të KLSH, gjithashtu të takohen me punonjësit, audituesit dhe ekspertët e ndryshëm të institucionit, duke marrë të gjithë informacionin e nevojshëm dhe duke i adresuar pyetje të ndryshme. Stafit i përgatitur mirë i KLSH ka qenë në dispozicion të qytetarëve gjatë kësaj periudhe kohore.

8. Konferencat Shkencore Vjetore të KLSH-së

Në shtatë vite, KLSH ka organizuar gjashtë Konferenca Vjetore Shkencore :

- Konferenca e parë me temë *"87 vjet KLSH në 100 vjet të shtetit shqiptar"* (dhjetor 2012);
- Konferenca e Dytë *"Roli i SAI-t për një menaxhim publik të përgjegjshëm në sfidat e sotme"* (Dhjetor 2013);
- Konferenca e Tretë *"Auditimi Kombëtar në shërbim të Qeverisjes Kombëtare"* (tetor 2014);
- Konferenca e katërt mbi *"Analizën e Riskut"* (qershor 2016).
- Konferenca e V-të e organizuar nga KLSH u mbajt në 11-13 tetor 2017 në Tiranë dhe u realizua si një bashkëpunim midis Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Tiranës, KLSH-së dhe Gjykatës Turke të Llogarive, me temë *"Auditimi, Qëndrueshmëri dhe Zhvillim"*.
- Konferenca e VI-të Shkencore e KLSH-së në bashkëpunim me SAI-n e Kuvajtit, *"Auditimi i Bazuar në risk"* (prill 2018).

9. Bashkëpunimi me OJF-të

Në vitet e fundit 2012-2018, KLSH ka nënshkruar 57 marrëveshje bashkëpunimi, nga të cilat 30 me OJF, 17 me institucione homologe dhe të tjera me institucione shtetërore dhe universitete publike. Bashkëpunimet me Profesoratin e Universiteteve dhe Organizatat Profesionale të fushës gjatë këtyre viteve, ka maksimizuar kontributin e tyre në Revistën Shkencore të KLSH-së, Konferencat Shkencore, trajnimet, rekrutimin e stafit, pjesëmarrjen e ekspertëve të shoqërisë civile në auditimet e KLSH, rishikimet mes kolegëve për të vlerësuar performancën e KLSH, etj.

10. Godina e re e KLSH-së

Për herë të parë në këto 93 vjet, audituesit e KLSH-së punojnë në një godinë të re, në kushte komode dhe moderne, duke iu krijuar mundësinë që të kenë më shumë produktivitet në punën e tyre.

ECA dhe KLSH - paralele të zhvillimit profesional të audituesve

Në datën 7 dhjetor në sallën “Lech Kaczynski”, u zhvillua një takim me auditues të Departamenteve të Auditimit dhe të strukturave mbështetëse. Në këtë takim, zj. Alnana Gjinopulli, Drejtore e Departamentit të Metodologjisë, theksoi se gërshetimi i vlerave të eksperiencave trajnuese të një prej institucioneve supreme të auditimit më të zhvilluara në botë, Gjykatës Evropiane të Audituesve (ECA) me kapitalizimin e zhvillimit profesional si rritje e ndjeshme e kapaciteteve audituese nga Kontrolli i Lartë i Shtetit nuk është i rastësishëm.

Si anëtar i INTOSAI-t dhe EUROSAI-t dhe partner i SAI-ve të BE-së, i ECA-s dhe GAO-s amerikane, KLSH e konsideron ndërtimin e kapaciteteve një proces të vazhdueshëm, të orientuar nga rezultati dhe objektivat. Kjo konsideratë rrjedh nga një prej 9 objektivave parësorë të Projekt-Idesë së datës 14 dhjetor 2011, prezantuar pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë, ku si kandidat i nominuar nga Presidenti i Republikës për detyrën e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Leskaj theksoi **“Zhvillimin e burimeve njerëzore të KLSH në nivelin e parametrave të kërkuar nga INTOSAI dhe në përputhje me sfidat integruese të vendit”**.

Qasjet inovatore të ECA-s, duke e konsideruar zhvillimin profesional të audituesit evropian në funksion të kërkshëm për njohuri të reja, trajnimet e stafit të porsarekrutuar (por jo vetëm) nëpërmjet transformimit nga vizioni në realitet, ofrimin e asimilimit të dijeve të reja në formate elastike, sipas pozicioneve të stafit, si auditues, ndihmës, ekspert, përgjegjës grupi auditimi apo drejtues i lartë, në formën e mësimin alternativ, apo si qasje e përzier për të maksimizuar rezultatet, si dhe si të mësuarit e integruar- një mjet për suksesin e organizatës, përputhen me qasjet e përzgjedhura nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Formatet inovative të ECA-s të trajnimeve për kolegët e rinj dhe me eksperiencë, programin “ASPIRE(Aspiro)” të saj për të sapo-rekrutuarit, ngritjen e aftësive praktike në piedestal në trajnimin e lidershit, bashkëpunimin e SAI-t të BE-së me stafet akademike nëpërmjet forcimit të lidhjeve midis audituesve dhe akademikëve janë në një linjë me qasjet e institucionit shqiptar të auditimit “KLSH-agjent whatchdog i qytetarit dhe Parlamentit” dhe “KLSH shërbestar i qytetarit”, si forca lëvizëse dhe njëherazi inspiruese për menaxhimin e ndryshimit të qeverisjes institucionale.

Si SAI, kemi konsoliduar reformat e ndërmarra që nga viti 2012 në menaxhimin e burimeve njerëzore, duke u fokusuar në realizimin e tre objektivave kryesore:

1. Zbatimin e kornizës legjislativë të shërbimit civil, implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI që mbulojnë fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore si dhe qasjeve e praktikave më të mira të identifikuar nga Komuniteti i INTOSAI-t .
2. Zhvillimin edhe instalimin e vlerave etike dhe të integritetit tek çdo anëtar i stafit të KLSH, që përbën parakushtin e kredibilitetit institucional dhe bazën e ngrëhës së besimit të qytetarëve tek institucioni i KLSH-së.

3. Zhvillimin e kapaciteteve me fokus rritjen e profesionalizmit dhe maksimizimin e produktivitetit të stafit të KLSH-së.

Kjo filozofi menaxhimi e burimeve njerëzore në institucion reflekton përmbushjen e objektivit prioritar të përcaktuar në Standardin ISSAI 12 “Vlerat dhe Përfitimet e Institucioneve Supreme të Auditimit-Të bësh diferencën në jetën e qytetarëve”, si dhe menaxhimin modern dhe efektiv të kapitalit njerëzor, në funksion të sigurimit të aftësive më të mira profesionale dhe njohurive mbi standardet ndërkombëtare të fushës.

Ashtu si Gjykata Evropiane e Audituesve (ECA) ka realizuar mësimin e vazhdueshëm, atë alternativ gjatë gjithë jetës dhe të mësuarit e integruar si mjete për suksesin e organizatës, gjatë periudhës 2012-2018, KLSH mundësoi transformimin nga menaxhimi tradicional i burimeve njerëzore në qasje më proaktive dhe inovatore të ndërtimit dhe zhvillimit të kapaciteteve njerëzore e profesionale, duke mësuar nga eksperiencat e trajnimeve të SIGMA, të ekspertëve të SAI-ve të përparuara evropiane partnere të tij, si Zyra Kombëtare e Auditimit e Polonisë(NIK), SAI i Kroacisë, Gjykata Austriake e Auditimit, SAI Çek, etj., mbi bazën e motos së INTOSAI-t “*Experientia mutua Omnibus prodest (Nga eksperiencia e përbashkët fitojnë të gjithë)*”.

Politika e ndjekur nga KLSH, e mbështetur nga Strategjia e tij e Zhvillimit 2013–2017, e rishikuar dhe me pas nga Strategjia e Zhvillimit 2018-2022 për zhvillimin e kapaciteteve audituese, ka synuar rekrutimin dhe mbajtjen e audituesve të aftë, të përkushtuar, të motivuar për të kontribuar në zhvillimin individual dhe më pas për të gjithë institucionin.

Sistemi ynë i menaxhimit të burimeve njerëzore është fokusuar në instalimin e procedurave efektive për të vlerësuar dhe plotësuar nevojat për stafin e ri të rekrutuar, si dhe njëkohësisht për të rritur dhe zhvilluar kapacitetet, aftësitë personale, karakteristikat individuale të audituesve, kontributet e tyre, potencialet, duke ofruar mundësi për mësim dhe zhvillim të vazhdueshëm.

Në kuadër të përmbushjes së objektivit për një menaxhim modern të burimeve njerëzore KLSH, ka ndërmarrë hapa konkrete dhe një sërë iniciativash për instalimin në institucion të një infrastrukture dhe sistemi efektiv të menaxhimit të kapitalit human dhe krijimin e profilit të një institucioni të besueshëm dhe profesional në optiken e palëve të treta –parlamentit, medias dhe publikut e qytetarit, si dhe subjekteve të auditimit.



Në përfundim, zj.Gjinopulli konkludoi që sikurse ECA sot drejton audituesit e saj në njohjen dhe përdorimin e teknologjive bashkohore “blockchain”, KLSH ka orientuar audituesit e tij në përdorimin e Sistemit të Informacionit për Menaxhimin dhe Mbështetjen e Proceseve të Auditimit, të quajtur RevZone, si një risi absolute për institucionin që lehtëson dhe plotëson tërësisht me informacionin e duhur drejtimin dixhital në auditim, si dhe ka krijuar bazën e të dhënave për subjektet e auditimit IT (ICTS Database) dhe ka zhvilluar Manualin Aktiv të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit. Ky manual elektronik, me vlera të padiskutueshme në analizimin e riskut, planifikimin e auditimit si dhe përdorimit të eksperiencës së auditimeve të mëparshme, përbën një risi jo vetëm për KLSH por edhe për komunitetin botëror të auditimit, si produkt që lindi, u testua në një auditim pilot, u përmirësua edhe me kontributin modest të audituesve të Teknologjisë së Informacionit të KLSH dhe është prezantuar në disa evente të grupeve të punës së IT së EUROSAT-t dhe INTOSAI-t. Ai është pranuar dhe po implementohet si një inovacion në fushën e auditimit nga komuniteti ndërkombëtar i Auditimit të T.I.